


# Produkti i Brendshëm Bruto, 2017

## Vlerësime finale 2016 dhe gjysmë-finale 2017

**Tiranë, më 29 Mars 2019:** Në vitin 2017 ekonomia shqiptare shënoi një rritje në terma realë (në volum) prej 3,82 %, krahasuar me vitin 2016, pas një rritje prej 3,31 % në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015.

Fig. 1 PBB dhe rritja ekonomike



Sipas të dhënave me baza vjetore, PBB me çmime korrente në vitin 2017 u vlerësua 1.551.281 milionë lekë (11,6 miliardë Euro) dhe 1.472.479 milionë lekë (10,7 miliardë Euro) për vitin 2016. PBB për frymë në vitin 2017 arriti në 540 mijë lekë (ose 4.024 €) nga 512 mijë lekë (ose 3.727 €) që ishte në vitin 2016.

Tab. 1 Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Vitet		
	2016*	2017**	
Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korrente (në milion lekë)	1.472.479	1.551.281	
Të ardhurat kombëtare bruto (në milion lekë)	1.496.393	1.563.540	
Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante krahasuar me vitin e mëparshëm (në %)	3,31	3,82	
Deflatori i PBB (në %)	-0,63	1,47	
Popullsia mesatare vjetore (në mijë banorë)	2.876	2.873	
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	Mijë lekë	512	540
	EURO	3.727	4.024
	USD	4.124	4.533


2016\* Të dhëna Finale

2017\*\* Të dhëna Gjysmë-finale

Sipas PBB-së me metodën e prodhimit, kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë degët e ekonomisë si “Administrata publike, arsimi dhe shëndetësia” me 0,94 pikë përqindje, “Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative” me 0,66 pikë përqindje, “Tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor” me 0,64 pikë përqindje dhe “Ndërtimi” me 0,63 pikë përqindje.

Taksat neto mbi produktet kontribuan respektivisht me 0,42 pikë përqindje.

**Fig. 2 Kontributi i degëve kryesore të ekonomisë në normën reale të rritjes së PBB 2017, në pikë përqindje**



Për sa i përket strukturës së PBB-së sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2017 vazhdojnë ta zënë *Shërbimet* gjithsej me 48,0 %, duke shënuar një rritje në terma realë me 6,06 %. *Industria dhe Ndërtimi* përbëjnë 20,4 % të PBB-së, të cilat u rritën në terma realë përkatësisht: *Industria* me -1,80 % dhe *Ndërtimi* me 7,04 %. *Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi* përbëjnë 19,0 % të PBB-së dhe janë rritur me 0,84 % në terma realë.


Deflatori i PBB-së për vitin 2017 është 1,47 %.

Sipas PBB-së me metodën e shpenzimeve, *Konsumi final* përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 91,21%. Ky komponent u rrit me 4,18% në terma nominalë dhe 2,25% në terma realë. Në strukturën e Konsumit Final është *konsumi final i popullatës* ai që zë peshën më të madhe me 79,04%, i ndjekur nga *konsumi i administratës publike* me 11,46% dhe *konsumi i institucioneve jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve (IJFSHF)* me 0,70%.

Në vitin 2017, *Formimi bruto i kapitalit fiks*, i cili përbën 24,53 % të PBB-së, u rrit me 6,06 % në terma nominalë dhe 5,51% në terma realë, krahasuar me vitin 2016.

*Eksportet e mallrave dhe shërbimeve* u rritën me 14,73 %, në terma nominalë dhe me 12,94 % në terma realë, ndërkohë që *Importet e mallrave dhe shërbimeve* u rritën me 7,13 %, në terma nominalë dhe 8,06 % në terma realë, krahasuar me vitin 2016.

**Fig. 3** Struktura e PBB-së me metodën e Shpenzimeve, në %



**Tab2.** Treguesit sipas aktiviteteve ekonomike

A10	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev. 2	Vlerat me çmime korrente në milionë Lekë		Vlerat me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)	Struktura e PBB (%)		Kontributi
		2016*	2017**	2017**	2017**	2016*	2017**	2017**
A1	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	292.287	294.966	294.728	0,84	19,85	19,01	0,17
A2	Industria gjithsej	180.221	173.827	176.969	-1,80	12,24	11,21	-0,22
2a	nga cila: Industria përpunuese	83.702	95.290	93.931	12,22	5,68	6,14	0,69
A3	Ndërtimi	131.089	142.248	140.314	7,04	8,90	9,17	0,63
A4	Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	234.438	249.832	243.887	4,03	15,92	16,10	0,64
A5	Informacioni dhe komunikacioni	45.336	47.838	47.231	4,18	3,08	3,08	0,13
A6	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	35.776	38.745	39.745	11,10	2,43	2,50	0,27
A7	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	85.838	87.275	87.187	1,57	5,83	5,63	0,09
A8	Aktivitete shkencore, profesionale , administrative dhe mbështetëse	85.598	97.388	95.348	11,39	5,81	6,28	0,66
A9	Administrata publike; Arsimi; Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	161.576	181.692	175.416	8,57	10,97	11,71	0,94
A10	Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi	39.044	41.315	40.463	3,64	2,65	2,66	0,10
	<b>Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë</b>	<b>1.291.203</b>	<b>1.355.126</b>	<b>1.341.289</b>	<b>3,88</b>	<b>87,69</b>	<b>87,36</b>	<b>3,40</b>
	Taksa neto mbi produktet	181.276	196.155	187.455	3,41	12,31	12,64	0,42
	<b>PBB ME ÇMIMET E TREGUT</b>	<b>1.472.479</b>	<b>1.551.281</b>	<b>1.528.744</b>	<b>3,82</b>	<b>100,00</b>	<b>100,00</b>	<b>3,82</b>

2016\* Të dhëna Finale

2017\*\* Të dhëna Gjysëm-finale

**Tab. 3 Treguesit e komponentëve kryesorë të Shpenzimeve**

Treguesit e PBB-së	Vlerat me çmime korrente në milion Lekë		Vlerat me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)	Struktura e PBB (%)		Kontributi
	2016*	2017**	2017**	2017**	2016*	2017**	2017**
<b>Konsumi Final</b>	1.358.073	1.414.895	1.388.667	2,25	92,23	91,21	2,08
<b>Konsumi Final i Popullatës</b>	1.179.608	1.226.151	1.207.199	2,34	80,11	79,04	1,87
<b>Konsumi Final i Administratës Publike</b>	165.938	177.820	170.718	2,88	11,27	11,46	0,32
Konsumi Individual	77.277	81.763	78.285	1,30	5,25	5,27	0,07
Konsumi Kolektiv	88.661	96.057	92.433	4,25	6,02	6,19	0,26
<b>Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse</b>	12.527	10.924	10.750	-14,18	0,85	0,70	-0,12
<b>Formimi Bruto i Kapitalit Fiks</b>	358.813	380.551	378.593	5,51	24,37	24,53	1,34
<b>Ndryshimet e gjendjeve</b>	12.603	8.032	7.885	-37,43	0,86	0,52	0,34
<b>Mospërputhje statistikore</b>	-8.837	-18.760	965		-0,60	-1,21	
<b>Eksporti neto</b>	-248.173	-233.437	-247.367	-0,32	-16,85	-15,05	0,05
<b>Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	426.693	489.532	481.922	12,94	28,98	31,56	3,75
Eksportet e mallrave	97.938	106.932	103.360	5,54	6,65	6,89	0,37
Eksportet e shërbimeve	328.756	382.600	378.561	15,15	22,33	24,66	3,38
<b>Importet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	674.866	722.969	729.289	8,06	45,83	46,60	3,70
Importet e mallrave	455.354	485.324	490.694	7,76	30,92	31,29	2,40
Importet e shërbimeve	219.512	237.645	238.595	8,69	14,91	15,32	1,30
<b>PRODUKTI I BRËNDSHËM BRUTO</b>	<b>1.472.479</b>	<b>1.551.281</b>	<b>1.528.744</b>	<b>3,82</b>	<b>100,00</b>	<b>100,00</b>	<b>3,82</b>

2016\* Të dhëna Finale

2017\*\* Të dhëna Gjysëm-finale

# Metodologjia

## Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e PBB-së mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Europian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993. Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit ose një tre-mujor). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare.

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë:

- Nomeklatura e veprimtarive ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomeklatura e produkteve (NP);
- Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit (COICOP);
- Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG).

## Burimet e të dhënave

Për vlerësimet e PBB-së përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT-it ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministrinë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Biznesit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe të tjera. Duke krahasuar këto burime me njëra-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë e cila është gjithëpërfshirëse, konsistente, koherente dhe tërësisht e integruar.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruar nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet, ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve; Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave; Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve; Anketa e Tregtisë me Pakicë; Anketa e Buxhetit të Familjeve; Anketa e Forcave të Punës; Anketa të Statistikave të Çmimeve. etj.

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore; Tatimi mbi vlerën e

shtuar (TVSH); Statistika financiare monetare; Bilanci i Pagesave; Statistika fiskale të qeverisë; Statistika të tregtisë së jashtme; Të dhëna mbi energjinë elektrike dhe të produkteve energjitike etj.

### **Fazat e publikimit dhe Politikat revizionuese**

Vlerësimet e PBB-së vjetore kalojnë në dy faza llogaritjesh dhe publikimesh.

- Faza e parë përfshin vlerësimet gjysëm-finale të llogarive vjetore të PBB të vitit "t", të cilat kryhen në periudhën t+15 muaj.
- Faza e dytë përfshin vlerësimet finale të PBB të vitit (t). Në këtë fazë rishikohen dhe njëherë të dhënat e vitit (t) kur vjen seti i të dhënave për vitin (t+1) me qëllim që të përfshihet çdo ndryshim i bërë për vitin (t) dhe të sigurohet konsistenca midis dy viteve të njëpasnjëshëm. Gjatë kësaj faze bëhet dhe balancimi final në nivel produkti midis dy metodave të PBB-së.

Të dhënat e publikuara revizionohen mbështetur në politikat revizionuese të llogarive kombëtare. Vlerësimet vjetore të Produktit të Brendshëm Bruto dhe komponentëve të tij janë subjekt i dy tipeve të revizionimit: të zakonshme dhe të veçanta.

#### *Revizionime të zakonshme:*

Revizionimet e zakonshme të PBB-së me baza vjetore janë rezultat i përditësimeve dhe plotësimit të burimeve ekzistuese të të dhënave me informacionin më të fundit për një vit të caktuar "t".

#### *Revizionime të veçanta:*

Revizionimet e veçanta vijnë si rezultat i përfshirjes së burimeve të reja të të dhënave statistikore e administrative dhe përmirësimi i atyre ekzistuese; përmirësimi të teknikave statistikore dhe metodave të përpilimit të të dhënave për Llogaritë Kombëtare; ndryshimit të metodologjisë për shkak të standarteve të reja të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA dhe ESA).

# Përkufizime

**Produkti i Brendshëm Bruto (PBB):** Produkti i brendshëm bruto, vlerësuar me çmimet e tregut, është rezultati final i aktivitetit të prodhimit nga njësitë rezidente prodhuese gjatë një viti. Ai është llogaritur sipas dy mënyrave:

- **PBB me mënyrën e prodhimit.** është i barabartë me shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ndryshme të aktiviteteve, duke shtuar tatimet e taksat e duke i zbritur subvencionet mbi produktet (të cilat nuk u janë shpërndarë sektorëve apo degëve të aktivitetit);

- **PBB sipas mënyrës së shpenzimeve** është i barabartë me përdorimet finale të brendshme të produkteve e shërbimeve (konsumi final efektiv, formimi bruto i kapitalit fikse, ndryshimet e gjendjeve), plus eksportet, minus importet.

**Prodhimi:** Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte e shërbime për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proçeset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim. Ekzistojnë tre lloje të prodhimit: prodhim tregu; prodhim i prodhuar për konsum final vetjak dhe prodhim tjetër jo-tregu.

**Konsumi i ndërmjetëm:** Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fikse.

**Vlera e shtuar bruto:** Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

**PBB nominal** mat vlerën e produkteve për një periudhë të caktuar kohore, me çmimet e periudhës në të cilin prodhohet produkti (çmimet e tanishme).

**PBB reale** mat produktin total të prodhuar në një ekonomi, për një periudhë të caktuar kohore, por duke marrë parasysh çmimet e një viti bazë (të dhënë-mundet me qenë viti paraardhës ose cili vit caktohet si vit bazë).

**Taksat mbi produktet dhe importin:** Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa dhe taksa doganore mbi importet.

**Subvencione në produkte:** Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njërive institucionale rezidente.

**Konsumi Final:** Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo-Fitimprurëse në Shërbim të Familjeve (IJFSHF).

**Konsumi final i familjeve:** Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

**Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse:** Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe IJFSHF dhe vlerës së prodhimit tregtar.

**Eksporti neto:** Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b).

**Formimi Bruto i Kapitalit Fiks:** Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

**Ndryshimi i gjendjeve:** Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit. Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera; prodhime, punime shërbime në proces; produkte të gatshme e gjysëm të gatshme, mallra, kafshë. etj.

**Çmim bazë:** Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

**Çmimet e tregut:** janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

**Çmime korrente:** Çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.



**Çmime konstante:** Vlerësimet me çmime konstante janë në vlerë reale pra të korrigjuara për ndryshimet në çmime në lidhje me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.